Kronikë

Shpërthim me tritol pranë banesës së Meard Berberit në Pogradec, organizator i sulmit me armë ndaj Hotel Volorekës në 2020! I dënuar 5 herë

Shpërthim me lëndë plasëse ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të sotëm më Pogradec. Objektiv ishte Meardi Berberi, 38-vjeç me precedent të theksuar penal. Merad Berberi konsiderohej si organizator i sulmit në hotel 'Voloreka' në Pogradec, më gusht të 2020, ndërsa në rolin e atentatorit ishte Anterio Kaloshi

■ Shpërthimi me tritol në Pogradec, fqinji: Ishte shumë i fortë, pastrueset i kapën copat e tullave! Thamë na erdhi 'rusi'

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
22 Korrik, 07:39 | Përditësimi: 22 Korrik, 09:28

Share

A A

POGRADEC- Gyteti i Pogradecit është tronditur nga një shpërthim tritoli në orët e para të mëngjesit të kësaj të hëne. Objektiv ishte Meardi Berberi, një person me precedent të theksuar kriminal, i dënuar 5 herë që nga viti 2011. 38-vjeçari rezulton pjesë e grupit që sulmoi me armë Hotel Voloreken në 2020 në Pogradec dhe doli nga qelia pasi përfitoi prej amnistisë. Merad Berberi bashkë me Ilir Berberin, konsideroheshin ***si organizator*** të sulmit në hotel 'Voloreka' në Pogradec, më gusht të 2020, ndërsa në rolin e atentatorit ishte Anterio Kaloshi.

Lëndë plasëse është hedhur në orën 02:30 në sheshpushimin mes katit të parë dhe katit të dytë të një pallati dhe sipas dëshmitarëve në zonë shpërthimi ishte shumë i fuqishëm.

> *'Shpërthim i fuqishëm shumë ne thamë se ra pallati. Kur dola pashë tym të zi. Pastrueset i hëngrën copat e tullave.'- u shprehë një dëshmitar.*

LEXO EDHE
'Nuk shesim dot pataten, qepën as grurin!' Fermerët e Maliqit në protestë, bllokojnë rrugën me zetora! Policia u vendos 70 gjoba me nga 1 mln lekë të vjetra secila

Meard Berberi, rezulton i dënuar 5 herë për vepra të ndryshme penale, duke nisur që nga plagosja e rëndë me dashje, prodhim dhe armëmbajtje pa leje e kundërshtim të forcave të policisë.

08.08. 2020 - Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake".

10.02.2019 - Kundërshtim i punonjësit të policisë", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike"

20.06.2008 - Plagosje e rëndë me dashje e kryer në bashkëpunim" dhe "Armbajtje pa leje".

24.02.2018 - Kanosje, Prishje e qetësisë publike.

24.04.2011 - Plagosje e rëndë me dashje

Njoftimi i policisë

> *'Rreth orës 02:30, në sheshpushimin e një pallati midis katit të parë dhe katit të dytë, në afërsi të banesës së shtetasit M. B, është hedhur një sasi e vogël lëndë plasëse dhe si pasojë ka vetëm dëme materiale. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë vijon punën për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.'- njofton policia.*

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 08:24

Shpërthimi me tritol në Pogradec, fqinji: Ishte shumë i fortë, pastrueset i kapën copat e tullave! Thamë na erdhi 'rusi'

Shpërthim me lëndë plasëse ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të sotëm më Pogradec. Objektiv ishte Meardi Berberi, 38-vjeç me precedent të theksuar penal.

Në një intervistë për Report Tv një nga fqinjët tha se shpërthimi ishte shumë i fortë dhe se u ndje shumë. Sipas tij pastrueset që ishin në punë në ato momente u prekën nga copat e tullave.

> *'Shpërthim i fuqishëm shumë ne thamë ra pallati. Ça u bë. Kur dola, pashë tym të zi. Pastrueset i hëngrën copat e tullave. Ajo ishte e tmerrshmja se ulërinë ato, atëherë dola. Policia erdhi vonë. Ishte tmerr fare, thash si bëjnë ata nga Izraeli nga Palestina. Unë thash na erdhi rusi.'- tha Berberi.*

M.Q./Shqiptarja.com

Share

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: pogradec tritol shpërthim Korçë meard berberi

Komento

Komente

Allauakbar: 22/07/2024 10:42

Surrat leshi Sunit , Arabo - Iranian

Përgjigju

Ridi: 22/07/2024 10:18

I denuar 5-here, me rrezikshmeri te larte dhe del me amnisti!!! C'fare tjeter per vec se eleminim pret qe te ndhodhe,

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
'Rasti Qefalia', a fshihen gjobat pas akuzave të Këlliçit, Nokës, opozitës?

Po Jo Ndjehta

Lajme të tjera

E rëndë në Gramsh/ Krishin dinamit në kroskot, makina shpërthen në ecje! Plagosen dy vëllezër (EMRAT)
21 Korrik, 17:37

Muzika elektronike gjalleron Korçën, DJ të huaj në festivalin 'LUMINA Elektronic' dhe spektakël dritash
Armand Braho
21 Korrik, 14:58

Vijon fluksi i udhëtarëve në portin e Durrësit, rreth 7.7 mijë pasagjerë pritet të mbërrijnë nga Bari! 27 sportele në funksion
21 Korrik, 11:38

"Zviceranët që jetojnë jashtë votojnë!" Ambasadorja nga Lini: Politika të marrë vendim unanim për diasporën
19 Korrik, 12:16

Terrorizoi zonën duke qëlluar me armë nga banesa, 71-vjeçari në Korçë lihet në 'arrest shtëpie'
19 Korrik, 10:47

Sarandë/ Shpërthen shtylla e tensionit të lartë, bizneset dhe banesat ngelin pa energji elektrike
19 Korrik, 09:24

Dikur ishte traditë, rikthehet kursi i notit në Pogradec! Trajnerët: Urojmë të arrijmë rezultatet e dikurshme
18 Korrik, 15:45

Korçë/ Zjarr në nënstacionin elektrik, disa zona pa energji elektrike
17 Korrik, 19:57

Xhovana Nikolli akuzon Nuredin Dumanin se i vuri tritol në derën e banesës: S'është burrë por ordiner
17 Korrik, 16:21

Pogradec/ Aksidentoi një të mitur me makinë, ndalohet 18 vjeçari
17 Korrik, 14:29

Korçë/ Kanosi babanë, dhunoi bashkëshorten dhe vodhi në një banesë, kapet 41 vjeçari i shpallur në kërkim
17 Korrik, 13:13

Korçë/ Poeti Skënder Rusi përkujtohet me mbrëmje poetike në 72-vjetorin e lindjes! I biri: Doréshkrimet dhe poezitë e pabotuara së shpejti në treg
Armand Braho
17 Korrik, 09:39

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje